



Prishtinë, 11 nëntor 2014  
Kodi i ZRRE-së: V\_662\_2014

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna me Nenin 14 pika 2.6 dhe Nenin 43, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.03/L-185;
- Dispozitat e Nenit 17 të Ligjit për Energjinë Nr. 03/L-184; dhe
- Shkresën / Njoftimin e Ngrohtores së Qytetit (NQ) Gjakova SH.A. të datës 27 tetor 2014 lidhur me vendimin e tyre për të mos aplikuar për ngritjen e tarifave.

**Në seancën e mbajtur me datë 11 nëntor 2014, nxori këtë:**

## **VENDIM**

- I. APROVOHEN** tarifat e ngrohjes qendrore për Ngrohtoren e Qytetit (NQ) Gjakova SH.A. për sezonin e ngrohjes 2014/2015, siç janë paraqitur në tabelat "A" dhe "B".

### **Arsyetim**

- Me datën 27 tetor 2014, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar shkresën nga Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Gjakova SH. A, me anë të së cilës ZRRE njoftohet se, menaxhmenti i NQ Gjakova, në koordinim me Bordin e drejtorëve, ka vendosur që të mos aplikoj për tarifat e sezonit të ngrohjes 2014/2015. Në këtë njoftim gjithashtu theksohen edhe arsyet për një vendim të tillë:
  - NQ Gjakova aktualisht ballafaqohet me vështirësi të mëdha financiare që vën në pikëpyetje aftësinë e ndërmarrjes për të siguruar lëndën djegëse – mazutin. Mes tjerash në këtë situatë të vështirë kanë ndikuar borxhet ndaj furnitorëve dhe kontraktorëve të ndryshëm, të shkaktuara në të kaluarën, e që sipas aktgjykimeve të formës së prerë është dashur që të paguhen në këtë vit, e që kjo ka ndikuar që e gjithë shuma e mbetur e subvencioneve të këtij viti të shpenzohet për pagesat e borxheve paraprake.
  - Pasiguria rreth subvencioneve nga buxheti i Kosovës, ku për shkak të mos rishikimit të buxhetit, nuk është e sigurtë nëse do të ketë dhe sa do të jete shuma e subvencionit për vitin kalendarik 2014 dhe në total për sezonin 2014/2015. Kjo është mjaft e rëndësishme kur dihet se një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve për lëndë djegëse mbulohen nga subvencionet. Për këtë, çdo planifikim i berë nuk është mjaftueshëm i sakte për tu përfshirë në aplikim tariforë.
  - Mungesa e subvencionit dhe aftësia shumë e limituar financiare për të siguruar lëndën djegëse e vënë në pikëpyetje se në që masë NQ Gjakova mund të ofroj furnizim me



ngrohje ne sezonin 2014/2015. Këto kushte e kanë berë shumë të vështirë planifikimet e duhura për një aplikim tariforë të kompletuar dhe të bazuar në parashikime reale.

2. Për vendosjen e tarifave të ngrohjes qendrore, ZRRE ka marr parasysh arsyetimet e paraqitura në shkresën e NQ Gjakova, të cilat i ka konsideruar të drejta dhe të argumentuara.
  3. Duke marr parasysh dispozitat ligjore të theksuara në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e shkresës së NQ Gjakova të datës 27 tetor 2014, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Struktura e tarifave të Ngrohtores së Qytetit Gjakova SH. A për sezonin e ngrohjes 2014/2015 është dhënë në tabelën e mëposhtme:

<b>TARIFAT PËR NGROHTOREN E QYTETIT GJAKOVË SH.A. PËR SEZONIN E NGROHJES 2014/2015</b>
--

<b>Tabela A. TARIFA PËR KONSUMATORËT PA MATJE</b>
---

NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVË SH.A.		
Komponentet e Tarifave	Konsumatorët shtëpiakë	Konsumatorët Komerเชียลë e Institucionalë
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	0.09 [€/m <sup>2</sup> për muaj]	0.12 [€/m <sup>2</sup> për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	0.88 [€/m <sup>2</sup> për muaj]	1.27 [€/m <sup>2</sup> për muaj]

<b>Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT ME MATJE</b>
---


NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVË SH.A	
Tarifa mujore e kapacitetit të ngrohjes (komponenta fikse)	0.91 [€/kW për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	58.76 [€/MWh]


- III. NQ Gjakova SH. A duhet ta publikoj këtë vendim, brenda pesë (5) ditëve të punës pas marrjes së vendimit dhe publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, në së paku një prej gazetave ditore me qarkullim të gjerë në Kosovë.
- IV. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë që të auditoj regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Gjakova SH.A. për të verifikuar realizimin e të Ardhurave dhe Kostove në sezonin 2014/2015.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Enver Halimi, Kryesues

  
Merita Kostari, Anëtare

  
Krenar Bujupi, Anëtar